

20180831488

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REVIZION SHTETËROR

Neni 1

Ne Ligjin për revizion shtetëror („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15 dhe 27/16), në nenin 5 paragrafi (2) pika 4) në alinenë 4 lidhëza “ose” zëvendësohet me presje.

Në alinenë 5 pika zëvendësohet me lidhëzën “ose”.

Pas alinesë 5 shtohet aline e re 6, si vijon:

APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2). “.

Pika 5) shlyhet.

Pikat 6) dhe 7) bëhen pika 5) dhe 6).

Neni 2

Dispozitat nga neni 5 paragrafi (2) pika 4) nga Ligji për revizion shtetëror (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/10, 145/10, 12/14, 43/14, 154/15, 192/15 dhe 27/16) dhe dispozitat nga neni 1 të këtij ligji me të cilin neni 5 paragrafi (2) pika 4) plotësohet me aline të re 6 nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 3

Kryerevizori shtetëror, përkatësisht zëvendësi i cili është i emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, është i detyruar ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Kryerevizorit shtetëror, përkatësisht zëvendësit i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohje të gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni i pushon mandati.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.